

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

834-1  
N 41

ISUF NELAJ

Po zurret  
pranvera  
vjersha

814-1

N 99

ISUF NELAJ

Po zbret pranvera

vjersha



13873

SHTËPIA BOTUËSE «NAIM FRASHERI»

## M O T I V E T

Nga fshati kam zbritur  
në Bibliotekën kombëtare

Pallton gri të malit  
shallin e bardhë të borës e lash në garderobë.  
Dhe bisedat shqetësimet e fshatit e qytetit  
nëpër raftet e gjata të bibliotekës.

Në sallë ka shumë studjues  
sa shumë heshtje sikur s'ka njeri,  
akustika e sallës sikur përplaset  
në mendimet e ngrohta të studjuesve  
dhe me një tingëllim të lapsit e fletës.

Letrat e shkruara si parcelat e mbjella,  
motivet plot zhurmë  
derdhen qetë-qetë  
nëpër brazdat e rimave e vargjeve.

## NË SYTË E XHA LOZIT DRITË

Fotografinë e Enverit e solli i biri në shtëpi,  
në sytë e xha Lozit dritë.  
Para syve të tij Herraj hoqi pardesynë e ullinjve  
në këtë mbrëmje  
e u vesh me dritë,

E sa korniza kishin pregetitur për portretin,  
plaku me drurin e zgjedhur në majën e Gamnit,  
djali me kallinjt e tarracave të malit,  
nusja me qëndismat e lëndinave të bukura.

Para syve të tyre Herraj hoqi pardesynë e ullinjve  
e u vesh me dritën e gëzimit.

Herraj, 1973

## A U T O K R I T I K E

Autokritikë, jo vetëm në mbledhje,  
autokritikë, belin, shatin më thellë,  
autokritikë dhe më shumë tokë e mbjellë.

Autokritikë, kuadri më shumë kalitje,  
teoria më afër praktikës,  
më shumë mund e djersë në stërvitje.

Autokritikë, më shumë libra të lexuar  
më shumë poezi të shëndosha,  
më shumë nota  
në pentagrame brazdash, shinash, rrugësh.

Autokritikë jo veç me fjalë.  
Shoku im mjek natën preu më shumë me gér-  
shërë,

mësuesi gjer në orët e vona  
në ëndrrat e voglushve ballin ka vënë.

Ta nxjerrim nga guaska e fjalëve  
autokritikën, s'e kemi të lehtë,  
ndaj kur ngrihem, fjalët rëndoja një si trarët  
e më derdhet mbi krye një dush me djersë.

## **PO ZBRET PRANVERA**

Pranvera po zbre,  
me dushin e shirave të buta  
po lan kokat e maleve nga shkuma e **dimrit**,  
po zbre nëpër kodra, nëpër fusha,  
duke tundur tufat e luleve të pemëve,  
po zbre duke u shlodhur  
nëpër stolat e tarracave,  
duke përfshirë tërë peizazhin tonë të ri.

Pranverë e re  
në zemrën tonë të re.

## QYTETI I ZONËS B

Toponomastika mbledh krahët t'i bëjë vend  
këtij qyteti këtu, ku fryn veriu i ashpër,  
në këtë grykë ku Valbona e Drini në marshim  
dorën njeri-tjetrit miqësisht i japin.

Këtu klubi i punëtorëve, këtu dyqane,  
nga çdo vend i atdheut këtu kanë ardhur,  
këtu të rinj të gëzuar, të reja të shkaththa,  
këtu dhe të fejuar dhe gra me barrë.

Këtu jeta rrjedh si ujët e lumit  
mes shqetësimesh të mëdha të ditëve e të  
netëve,  
mes shpërthimeve të betejave e fitoreve  
me driten bashkë lindin edhe njerëzit.

Toponomastika mbledh krahët e t'i bëjë vend  
toponomastikës së re të këtij qyteti,  
ku pa gojëdhëna, pa legjenda, thjeshtë  
u bë emërtimi i çdo vendi.

## SHOQES SË KLASËS

Shoqe e fëminisë,  
në oborrin e kujtimeve vjen shpesh  
me atë çantë të vogël,  
me ata flokë të lidhur me fjongo.

Ajo fjongo si ylber bashkon dekadat,  
ajo fjongo si ylber që s'e preka kurrë.

Ajo fjongo sot mbush horizontin, largësinë  
e na lidh ne nëpër skelat e ditëve  
duke lartësuar vitet e së ardhmes,  
ajo fjongo...

## KUSH E KISH KËRKAUAR NJËRI-TJETRIN MË SHUMË

Fundi luftës po i vinte,  
nëna tanë kishte gjetur miell;  
me bukë në trastë ekte nëpër pyll,  
kërkonte intendentin,  
që e nisi pa bukë nga shtëpia një ditë.

Ndërkohë, intendanti, me një thes miell **mbi**  
**mushkë**,  
po kërkonte atë shtëpi mes shkrepave,  
ku nëna pa bukë kishte atëherë vënë në **gjumë**  
dy fëmijët,  
duke i tundur me djepen e shpresave.

## ME KOSTUMIN E MURRMË TË DIELLIT

Vajzës, që u kthye nga shtëpia e pushimit të pionierëve Durrës.

U ktheve nga shtëpia e pushimit të pionierëve,  
nga bregdeti,  
e kënaqur nga lëkundjet në shilarsin e valëve,  
në sytë e tu valët e detit,  
në buzët e tua kripa e detit.

Erdhe në shtëpi me dashurinë e madhe, sa deti,  
për prindërit,  
deti të kishte falur shumë kaltërsi në sy,  
dielli të kish veshur kostumin e murrmë të  
rrezeve.

U ktheve me imazhin e rivierës,  
me faqet e mbushura nga shëndeti,  
rivierë dhe në fytyrat e prindërve gjete!

## **KUSH E HOQI KËTË DIAGONALE**

Kush e hoqi këtë diagonale të shtrembër  
mbi drejtkëndshin e blertë të grurit?  
Kush shkeli me thudrat e shpërdorimit  
jetën e mijëra kallinjëve,  
tryezën e përbashkët të bukës.

Pikëpyetjen në fund të fjalisë s'po e vemë.  
Brenda në ndërgjegjen e dëmtuesve,  
jashtë mbi veshokët e indiferentëve  
le të bjerë ajo si shufër kritike e rreptë.

## **QERSHORI NË FIERZË**

Qershori me ditë të tendosura,  
të ngarkuara kaq shumë  
  me shkëmb, beton e **gurë**,  
me shpërthime kaq të mëdha,  
muaj sulmi në Fierzë,

Qershori.

Drini shikon vëngër shtratin e ri.  
Qershori — vagoni më i rëndë  
  i lokomotivës së muajve në Fierzë.

## RRUGËS PËR FIERZË

Në autobus inxhinieri, që u përcuall nga e fejuara,  
në sytë e tij, sytë e kaltër të së fejuarës  
me kaltërsinë e Valbonës janë përzierë.

Në autobus punëtori i ri nga Shkodra,  
në sytë e tij shkëndijat e syve të nënës  
me gazin e syve të gjithë Shqipërisë përzierë.

Në autobus bisedat e të gjithëve ecin  
për në Fierzë.

Mbi parashikimet, mbi buzët e tyre,  
mbi qepallat e rënduara  
është ulur Fierza,  
mbi duart e të gjithëve  
pesha e digës gjigante.

## **DEVIJIMI I DRINIT**

Dhjetë ditë na ndajnë nga devijimi i Drinit,  
këto fjalë të shkruara në hyrje të tunelit,  
në zemrën e gjithsecilit,  
në ballët e kantierit.

Drini i devjuar jo veç në skica  
jo veç ndër plane,  
së shpejti shtratin po e le të lirshëm,  
për të ngulur themelet diga gjigante.

Çdo ditë, çdo orë, çdo minutë e llogarisin;  
Drini së shpejti nis devijimin,  
si ushtar i bindur do të kthehet gjysmë djath~~tas~~  
nën komandën e ditës së inaugurimit.


Fierzë, qershori 1974.

## SIKUR HYRI NË BOTËN E GJERË TË KOLEKTIVIT

Ai hyri në ndërtesën me punë vullnetare.  
Sa i madh si apartament!  
Aty gjithë netët, ditët, të djelat e harxhuara  
të kolektivit.

Aty pranë buzëqeshjes së gruas, fëmijëve  
buzëqeshja e shokëve mbush plot dhomat.

Hyri në apartamentin e ri  
me shlodhjen pas punës, me jetën e tij.  
Ai hyri në këtë apartament të gjerë, të ngrohtë,  
sikur hyri në botën e gjerë e të ngrohtë të  
zemrës së kolektivit.



## B E T O N O J M È

Me djersën tonë, me hekurin, çimenton e maleve  
tona  
betonojmë tunelet në Fierzë.

Betonojmë në këmbët e kësaj qyteze në veri,  
betonojmë gjigantin metalurgjik,  
Ballshin,  
betonojmë këmbët e mijëra pallateve,  
të dhjetra qyteteve të rinj.

Betonojmë  
me djersën, hekurin, çimenton e maleve  
lartësitë e heroikës së ditëve,  
ndërgjegjen e re.  
soletat e poemave.

## D H E M B J E

Dimri rëndon mbi çatitë e shtëpive  
dhe strehët lotojnë,  
gjyshja na la këtë natë dimri,  
na la bardhësinë e shpirtit të saj,  
kujdesin e bardhë mbi tavolinë e dollap,  
qumështin e gjellën e ngrohtë.  
bisedën e pambaruar pranë zjarrit.

Na la këtë rregull kaq të madh në shtëpi.  
Çdo gjë këtu sikur ka ulur kryet  
si strehët pikojnë  
qerpirikët e të gjithëve.

## MARTESE MË MBLESËRI

Nusja si një top dëbore zbritur nga bjeshkët,  
dhëndri si një i huaj në shtëpinë e tij.

Vështrimet e të dyve sikur thyejnë kristalin e  
kurreshtjes.

Kaq afër njëri-tjetrit!

Në këtë dhomë shumë ditë ustallarësh,  
shumë ditë marangozësh e jorganpunuesish janë  
mbledhur.

Sa e pasur kjo dhomë!  
Sa e varfër kjo dhomë!

## **KAQ AFËR FSHATI ME QYTETIN**

*Punonjësve të fshatit Herraj e Pris-kë, që punuan për ndërtimin e ujë-sjellësit të ri në Buvillë, për t'i shtuar ujin kryeqytetit.*

Buvilla zhurmon në këtë korridor malesh,  
ku mbështilen erërat, tramundanet,  
sinfoni e re e punonjësve të fshatit e vullnetarëve  
në këtë orkestrinë ujvararesh.

Në këtë vend,  
ku zhvillohet beteja e ashpër me shkëmbin  
një shtrat i ri i hekurt për ujin po shtrihet.

Në këtë fresk  
kaq afër buzët e përcëlluara të kryeqytetasve  
                                     në furrat e shkrirjes,  
kaq afër ballët e djersitura të fshatarëve,  
kaq afër fshati me qytetin.

Për miqësinë  
t'i ngremë bashkë gotat me ujin e pastër e të  
kthjellët si gëzimi rinor,  
si dashuria jonë proletare,  
të ngremë dollinë, shokë!

## ME ÇANTËN E MBRESAVE TË VERIUT

Sa mirë!

Këtu mes njerëzish në luftë me shkëmbin,  
këtu në thellësi pranë zemrës së tokës,  
pranë shiritave të rrugëve që mbajnë medaljet e  
qytezave të reja,

Në çantën e mbresave të Veriut,  
Drini me trup të dridhur në kthesën drejt shtratit  
të ri,  
rezervuari i këthjellët pasqyrë e Alpeve,  
krahët e Fierzës shtrirë drejt metalurgjikut,  
Ballshit.

Në çantën e mbresave të mia  
projekte, skica inxhinierësh,  
net të përgjysmuara,

Në Uzinën e bakrit në Kukës  
shoku im tetë orë rresht para furrës së shkrirjes,  
tetë orë rresht në temperaturë të lartë.  
Ujvare djerse në brinjët e tij,  
ujvare e kuqe bakri në uzinë.

Në çantën e mbresave të mia  
një dasmë e pashlyer nga kujtesa:  
në sallën e shtëpisë së kulturës,  
mbi tryezën e çiftit të ri  
buzëqeshin pranvera e vjeshta.

Çanta ime plot mbresa,  
plot skela veprash, kapriata, soleta,  
çanta ime si çantë gjeologu  
me kampione nga thellësitë e tokës,  
nga pasuritë e shpirtit të punëtorëve.

Çanta ime e rëndë...

## NË INSTITUTIN E LARTË BUJQËSOR

Këtu ëndrrat e blerta  
plot si pemët, si vreshtat.

Këtu tarracat e Jonit, bregdetit,  
tarracat e Bizës e Shishtavecit.

Këu portokallet e Jugut,  
mollët, gështenjat e Veriut.

Këtu peizazhi më i bukur i atdheut  
në sfondin e përfytyrimit të studentëve.

Këtu me Darvinin, me Luibing e Haber Bësh  
debate bëjnë studentët gjer vonë.

## PËLLËMBË E NËNËS

Udhë e mbarë, bir!

Pëllëmbën e nënës mbi kokën time të qethur  
e zuri era e ngrohtë, që më përkëdhel gjithë rrugës.  
Fjalët e saj: Udhë e mbarë,  
m'i mban era si kufje pranë veshit.

Pëllëmbë e nënës kështu e ngrohtë mbeti  
mbi kokën time të qethur,  
ajo u kthye në bustinë mbi kokë,  
ajo u kthye në helmetë.

## KTHIM NGA TAKTIKA

Ecim me hapat e rëndë,  
reshjet mbi shpatulla na rëndoijnë gjithnjë,  
ecim nëpër reliefin e qullur  
me gjokse erën shtyjmë.

Kokat tona nëpër degët e pranverës u maskuan,  
lodhja nëpër buzëqeshjen e fitores,  
djersa nëpër rrëketë e reshjeve.

E rëndë pesha e paimeve mbi shpinë.  
e rëndë dhe e lehtë  
peshë e gëzimit të fitores mbi shpinë.

## K O M A N D A N T I

Urdhëri i prerë i komandantit,  
vështrimi i ngrohtë i komandantit,  
ç'përtëritje!  
Sikur i ul malet,  
sikur i ngushton lumenjtë,  
i shkurton rrugët e gjata të lodhjes.

Këmbët në dëborë lënë gjurmët e peshës së  
madhe,  
por fjala e komandantit si pambuk i butë,  
mbi shpatull nën peshën e mortajës.

Kur kemi pranë komandantin,  
në këngët tona ka më shumë zjarr:  
në bisedat tona më shumë humor,  
më shumë horizont.

## **LETËR NGA GRUAJA**

O Hamza! Letër  
nga... gruaja!  
Sikur u drodh fusha,  
sikur gjithë vështrimet vërshuan në sytë e tij,  
turpi i shpërtheu lulëkuqet në fytyrë.

Kjo letër e dashur,  
si një copë bardhësi nga alpet,  
si një arë me misër të lartë,  
si një dhomë me mobilje të reja,  
kjo letër...

Lexon...

Po pse në fund këto shkronja të thyera,  
si misri nga era?

Mos vallë, kur ka shkruar, i është dridhur dora  
nga turpi  
se në fund e pa vjehrra:  
«Qyqja, letër burrit!»

## SE NATA NUK FLE

Dhe ti' s'fle, gjysh,  
me peshën e viteve mbi supe,  
një detyrë dhe ti more sonte.

Ti s'fle, se nata s'fle sonte,  
me sytë katër çan natën.

Sheh qytetin, që duket si një liqen dritash  
në sfondin e mbrëmjes,  
gjithë qyteti pranë zemrës tënde.

Përgjon,  
rrallë shkel kalldrëmet e heshtjes,  
dhe hedh vështrimin nga qyteti,  
thith çibukun e fabrikave.

## NUK ËSHTË E VËRTETË

U vra komisari.

Mali përçolli krismën e breshërive,  
mali uli kokën,  
përplasi jehonë dhembjeje,  
jehonë thirrjeje për hakmarrje.

U vra...

Ndali ajo zemër e madhe,  
që na filtronte zemrat, shkrinte akullin,  
ajo zemër, që na ngrohte këmbët e buavitura,  
që na mbulonte me dashurinë e madhe netëve të  
ftohta.

U vra komisari? Si!...

Ora e ditës akrepat ndali,  
kur e vendosëm përgjithnjë në atë lëndinë pranë  
ullinje,  
pranë gjelbërimit të pérhershëm.

U vra...

Jo s'është e vërtetë.

Në marshim për betejën e re drejtohemë,  
por ai afrohet gjithnjë më thellë,  
duke rënduar mbi çdo zemër,  
me më të madhen peshë.

**VOGËLUSHES, QË DO TË BËJË ROJE NË VARREZAT  
E DËSHMORËVE**

Dhe nëpër gjumë, në ëndërr  
qielli i heroizmit me yjet e pashuar  
në përfytyrimin e saj u mblodhën,  
njëzet e tetë mijë dëshmorë.

Dita e nesërme e madhe.  
Gëzimi e shqetësimi në një bankë.

Nesër,  
me shallin e gjakut të tyre në qafë,  
  do të bëjë roje nderi.  
Nesër pranë diellit të përflakur,  
pranë peshës së rëndë të atdheut nga trupi i tyre  
  gjithë plagë,  
pranë trandafilave të kuq dhe pranë vdekjes.

Nesér,  
ëndërrat e saj gjithë lulëzim,  
si lastarë të rinj,  
në trungun e ëndrrave të tyre të prera.

## N E N E . . .

*Për agronomin komunist G. B.*

Nënë, pse me mall kaq shumë shtrëngon têt bir?  
Shiko, a nuk vjen kështu më i fuqishëm,  
me acarin në kokë,  
me krenarinë e maleve  
e buzëqeshjen e fushës?

Yt bir komunist  
me punë larg teje,  
karrikja e tij një copë shkëmb i pa gdhendur,  
                                     një lëndinë a buzë kanali,  
gëzimi i tij në kallinjt' e mbushur.  
në një rrugë të çelur mes pllavit të dëborës,  
urë e madhe mbi lumenj  
                                     për të kapërcyer vështirësitë.

Biri yt komunist  
kaq larg teje,  
kaq afër popullit!

**PËR NJË KRYETAR TË KËSHILLIT POPULLOR  
TË FSHATIT**

Në dosjen e tij po fryn flladi i ftohtë,  
në zyrën e tij qëndronte i ngrrohtë «miku»,  
interesi personal kulloste qelepir  
në arat e gjera të kooperativës.

Nëpër dosjet e tij fryn flladi i fortë  
i kontrollit punëtor.  
Sa shpejt u shfletokan dosjet!  
Proces-verbalet e dëmtimit «të mikut», «të  
shokut»  
u gjetën të strukur si lepuj.

## BURRI ME LAVATRİÇE

Burri me lavatriçen, e blerë, në karrocë,  
kalon nën vështrimin e ballkoneve të qytetit.

Sa rroba të varura ndër ballkone,  
pasqyra të lodhjes së duarve të grave,  
pasqyra të pushimeve të humbura.

Kalon nën qortimin e ballkoneve të zbardhura  
me shpirtin e pastër të grave.

-- Pse kaq vonë?

Kalon nën përshëndetjen e duarve të bardha të  
grave.

-- Të lumtë!

## DY VJERSHA PËR ALBANËN

*Albana dhe gjyshja*

Ime bijë, Albana, zgjat duart te koka e gjyshes,  
e ç'kërkon atje?

Do të ngjitet te thinjat e viteve?

Gjyshes me doçkat e vogla i nduk thinjat,  
i shkul brengat e viteve,  
i fshin pluhurin e lodhjes.

Me mollëzat e buta të gjishtrinjve,  
i mbush vijat e rrudhave.

Albanaçon duart te rrudhat e viteve.

të shkruara në ballin e gjyshes,  
gjyshja çon dorën ledhatuese te faqet e  
mbushura të mbesës.

## **DUART E ALBANËS**

E ku rrinë të qeta ato duar fëmije,  
që tani marrin llaçin, gurët,  
sikur duan të lidhin muret e qyteteve të  
ardhshme,  
që tani zgjaten drejt thellësive.  
sikur kërkojnë në thellësi<sup>'</sup>ë e botës  
elementët e pazbuluar nga Mendeljevi,  
që tani zgjaten nga hekurat e maqinat,  
sikur duan të thonë:  
këto duar s'do t'i zëvendësojë kurrë kibernetika.

## KËSHILLË

E kush është snaiper më i mirë se ti,  
armiku i dridhet syrit tënd.

Po në shoqërinë tënde të shëndoshë  
njeri është parazit,  
po në thjeshtësinë e veshjes njeri hodhi një njollë,  
po në shoqërinë tënde  
dikush e shikon botën me «një sy të myllur e  
një vesh të shurdhur».

Shoku im, si snaiper në front  
ti armikun e pret me zjarr,  
po në sektorin tënd,  
nëpër llogoret e heshtjes  
po futet armiku,  
hap sytë!

## F J A L È T . . .

Rroftë Partia,  
në buzët e komunistëve, që ranë atë mbrëmje,  
duke shkruar një faqe të re të lavdisë shqiptare.

Rroftë PPSH, thirrje e punëtorëve të uzinës së  
shkrirjes,  
e shkruar në fasadën e hyrjes  
me ngjyrën e flakës që shkrin çelikun.

Rroftë PPSH, fjalët  
e çdo kooperativisti  
të shkruara në faqet e parcelave  
me djersën e pastër.

Rroftë PPSH, fjalë më të ngrohta të nënave,  
të shkruara, në zemrat e voglushëve,  
me qumështin e gjirit.

## SA E MADHE ATË DITË

*Heroinës së popullit Fato Sako Berberë*

Një trekëmbësh zgjatej drejt qafës së jetës tënde.  
Ti, si në betejë, përpara,  
me fjalët si bomba,  
me vështrimet si bazoneta ndaj armiqve.

Ti do të vareshe, po kush dridhej?  
Nën plumbat e qëndresës tënde nazistët,  
kampi nën këmbët e tyre,  
perëndimi në sytë e tyre.

Ti do të vareshe, po kush dridhej?  
Fato, Fato, vajzë e re sa e vogël ishe,  
por sa e madhe atë ditë,  
shtangu Selaniku!

Një trekëmbësh zgjatej drejt jetës tënde,  
por ti sa e madhe!  
A mund të varesh një madhështi si ti?

## KËSHTU E QËNDISE ATË QILIM

*Dëshmores Hava Kërkhalliu, e cila  
pati qëndisur një qilim me shkro-  
njat V.F. L.P,*

Kështu e qëndise ti atë qilim,  
ato shkronja si vezme me dëshirat e tua  
mbi gjithë atdheun në shpërthim,  
ato shkronja me gjakun e zemrës shkruar.

Kështu e qëndise ti atë qilim,  
me idealin e madh në mes fiksuar  
e mbeti si relik ai qilim  
në muzeun e kohës shtruar.

## NE ZEMRËN E GJITHË FËMIJËVE

— *Zeliha Allmetës* —

E pritën fëmijët  
në atë breg lumi.  
Një shami të bardhë  
me krahë valësh tundi.

E kërkojnë fëmijët,  
por ajo shumë lart,  
mbi kokat e Alpeve  
shami e saj zbardh.

E kërkojnë fëmijët,  
por ajo ndër fusha  
gjokset e gjith nënave  
me bardhësi mbushka.

E kërkojnë fëmijët,  
por ajo shumë thellë

rrënje heroizmi  
ke shoqet ka hedhë.

E gjejnë fëmijët  
në zemra, në këngë.  
Thith nga gjiri i saj  
fëmini e tërë.

## Ç'MADHËSI PARCELASH

Unë banoj në qëndër të ndërmarrjes bujqësore.  
Mëngjesi gjithnjë më troket me degët e pranverës  
në penxhere,  
mjelset, bashkë me rrezet,  
spërkatin me qumësht mëngjesin.

*Parcelat këtu, gjithnjë në rritje.*  
*Traktoristët në dasmën e pranverës*  
*copëtojnë natën me orkestrinë e aggregatëve.*

Nëna vjen nga puna  
me aromën e domateve të hershme,  
gruaja me imazhin e parcelave të grurit,  
që me vijat kulluese iu ka hequr lagështirën  
si rrobet e qullura fëmijës.

Vëllai vjen me çizmet e rënda tërë baltë,  
godet sadopak lustër në qenien time intelektuale.

Drejtori i ndërmarrjes vjen që pa gdhirë,  
kujdesi vrapon më shpejt se xhipsi i tij,  
bimët, lopët si prind i shikon, sikur i pyet  
                            mos kanë mërdhirë;  
në zyrën e drejtorit llampa e shqetësimit s'shuhet  
                            gjer natën vonë.

Unë banoj në këtë ndërmarrje bujqësore,  
ku pranvera ka sfiduar dimrin,  
Po unë pse të ngelem pas pranverës?

## PO NGJITET NË SKENË

*Shoqes N. O. nënë me 4 fëmijë, dilletante e dalluar.*

Në ansamblin e këngëve të fshatit  
vjen ajo, sjell rininë e saj të përhershme,  
sjell gazin rinor të fëmijëve të saj,  
duke çarë retë e thashethemeve.

Ngjitet me kënaqësi në skenë,  
me këngë punëtorëve t'u fshijë lodhjen.  
Duartrokitjet e shoqeve e të vogëlushëve në  
sallë,  
buqeta më të bukura për fitoren.

«RËNIA E VARSHAVËS»

Një largim i mallshëm nga atdheu,  
që aq shumë e donte,  
me dimrin e ashpër e verën e thatë të  
Kostancës,

me një trastë dhë të vendlindjes,  
me një thes me halle në shpinë,  
me një thes me nota në shpirt.

Shopen, për ku?!

Si nota plagët e dhembjes, për atdheun e  
pushtuar,  
i vure në partiturat e rrugëve,  
i vure për etydin «Rënia e Varshavës».

Shopen, Shopen,  
ai grusht dhë i vendlindjes te koka  
sot përsëri të kujton atdhenë  
përsëri nota të dhembshme  
në etydin e ri «Rënia e Varshavës».

## **GLOBI RRETH BOSHTIT TË SHQETËSIMIT**

Rrotullohet globi në orbitën e progresit,  
duke sjellë stinët, ditët, netët,  
globi i përflakur nga revolucionet.

Rrotullohet globi ngarkuar rëndë me ëndrrat,  
shqetësimet, shpresat e popujve,  
rrotullohet duke shtërnguar fort meridianet  
si rripat e paimeve.

Shqetësohet globi,  
mbi të Kili, si një shirit i zi,  
mbi të duart e CIA-s zgjaten.

Rrotullohet globi,  
i dhembin globit brinjët,  
kur mbi brinjët dhe kurrizin e fëmijëve të varfër  
bien shkopinjtë e atit Fridrih.<sup>(1)</sup>

---

1 — Ati Fridrih — Prift spanjoll, i cili përdor shkopinj pér të rrahu fëmijët në kolegj.

I rrëqethet globit lëkura  
për eukoplastet e Gutardit<sup>(1)</sup> mbi lëkurën e  
fëmijëve.

Rrotullohet globi  
me të papunët,  
që flenë nën gjilpërat e të ftohtit,  
nën shiun e pikëpyetjeve të së nesërmes.

Rrotullohet globi  
Afrika shtërngon rubinetën e naftës,  
uri e zi, fryt i zemrës së tyre të bardhë,  
mjaft mbushi kasat e botës kapitale,  
mjaft me gënjeshtra as luftë as paqë.

Rrotullohet globi.  
I shtytur nga erërat e revolucioneve,  
rrotullohet duke shkundur nga trupi  
parazitët, kalbësirat e kohës.

Rrotullohet globi.  
I skuqur nga flamujt e kuq,  
globi me shpresat e popujve në lëvizje, në  
mësymje,  
shtërngon meridianët si rripat e pajimeve.

---

1) — Gutardë — Doktor, që bën eksperimentet në fushën  
e mjeksisë me fëmijët e varfér duke rrezikuar kështu jetën  
e tyre.

## B A R D H E S I

*Në kompleksin blegtoral Kamzëz.*

Dy orë pas mesnate  
kërcasin dyert,  
gumzhijnë rrugët e Kamzës,  
si lumë i bardhë drejt kompleksit blegtoral  
derdhen mjelset me bluzat e bardha.

Mbi qerpikë mbajnë natën,  
mbi supe peshën e madhe të planit,  
në sy yjet,  
në ballë hënën.

Traktoristët rrugorë, me rimorkiot plot  
njomishte  
si kodra, si peizazhe të blertë në lëvizje  
drejt këtij kombinati të qumështit.

Peizazh i blertë i fushës gëlltitet  
e në bardhësi të këndshme hidhet ndër  
bidona,  
të mbushë dyqanet e kryeqytetit,  
të mbushë faqet e fëmijëve plot shëndet.

Kamëz, 1973.

## NË SERAT E SHPIRTIT TËND

*Brigadieres së serave në NB Kamëz.*

Fidanet në serat e tua,  
si copëza pranvere mes dimrit

Dhe pse natën u lanë hapur disa penxhere  
për ajër,  
më kot kërcënnon furtuna,  
më kot kërcënnon rrebeshi me grushtet,  
ti çan natën, gjumin në çdo orë,  
masat merr në vend.

Riten ato fidane ngrrohtë në serat mes  
fushës,  
rriten ngrrohtë në serat e shpirtit tënd.

## TRAKTORISTIT

Me traktor çan tokën,  
Në faqe parcelash mbjell pranverën e vjeshtën.  
Pranë kabinës së traktorit të tij duart e nënës  
në trikon e ngrohtë.

Dielli i mëngjezit ka ardhë ta përqafojë  
Perëndimi i vesh fytyrën me bronx.  
Hëna si buzë e së dashurës së tij.

Traktori këndon  
Me traktorët e tjerë një kor  
në koncertin ku deshifrohen partiturat e arave.

Traktori një shtëpi e dytë  
Gëzimi matet me brazdat, me parcelat  
Buzëqeshja e tij, buzëqeshja e parcelave  
Krah së dashurës së tij pranvera e vjeshta.

## G O D I T J E

Ç'pate që ma godite me baltë  
heshtjen time të derdhur,  
në montimin e shinës së gjatë,  
në rrugën e hekurt.

Më larg se me të gjithë ke qëndruar **me mua**,  
po ç'pate që më godite me baltë,  
pse mbi prushin e dashurisë sime  
hodhe një krahë kashtë?

## N E T E D Y

Ne, të dy —  
Një bisedë e gjatë,  
e shkurtër për të  
dhe gjithë kjo natë.

Me ne dhe hëna,  
me ne dhe yjet,  
ëndërrimet tona  
prekin galaktikën.

Ecim së bashku,  
me ne fusha qesh,  
rruga e përbashkët  
sa e shkurtër qe!

## Ç D O M E N G J E S

Çdo mëngjes, kur shkoj në brigatë,  
si qerpik i diellit, që del përmbi mal,  
qerpikët e syve të tu, o vajzë!

Çdo mëngjes, kur shkoj në brigatë,  
një lindje e re dielli më përshëndet.  
Sa e shkurtër dita,  
kur më uron punë të mbarë,  
o vajzë!

Çdo mëngjes, kur shkoj në brigatë,  
sytë tanë sa shumë flasin me vështrime.

Dy shatat tanë të parët prijnë,  
dy zemrat tonë acarin shkrijnë,  
kur punojmë bashkë.

## S A M I R E !

Sa mirë, kur vjen kështu, e larë nga baltrat,  
tymrat.

Hëna me rrezet mbi flokët e tu fiksuar  
dhe yjet në sytë e tu salduar  
dhe thjeshtësia e veshur në trupin tënd  
si përparsja e verdhë e fushës.

Sa mirë, kur vjen kështu në takim!

## N E P U S H I M E

Razma shtron peizazhin e blertë të lëndinave  
në sallonet natyrale të shlodhjes,  
për punëtorët e ardھur nga kantieret.

Veleçiku ul kokën  
me coprat e bardha të reve,  
me puplat e blerta të bjeshkëve  
na fshin djersën e ballit.

Pishat me aromën e freskët  
na mbushin mushkëritë.

Qetësia këtu e etur për të thithur tërë zhurmën e  
kantiereve.

Në këto kolltuqe lëndinash  
sa shkëmbime bisedash  
shkrirje metali, derdhje uji në turbina!

Nëpër biseda gjithë gjymtyrët e hekurta të  
atdheut në lëvizje.

Në pushime këtu,  
forcat, energjitetë në përtëritje.

Razëm, 1974

## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Motivet .....	3
Në sytë e xha Lozit dritë .....	4
Autokritikë .....	5
Po zbret pranvera .....	7
Qyteti i zonës B .....	8
Shoqes së klasës .....	10
Kush e kish kërkuar njëri-tjetrin më shumë .....	11
Me kostumin e murrmë të diellit .....	12
Kush e hoqi këtë diagonale .....	13
Qershori në Fierzë .....	14
Rrugës për Fierzë .....	15
Devijimi i Drinit .....	16
Sikur hyri në botën e gjerë të kolektivit .....	17
Betonojmë .....	18
Dhembej .....	19
Martesë me mblesëri .....	20
Kaq afër fshati me qytetin .....	21
Me çantën e mbresave të veriut .....	23
Në Institutin e Lartë Bujqësor .....	25
Pëllëmbë e nënës .....	26
Kthim nga taktika .....	27
Komandanti .....	28
Letër nga gruaja .....	29
Se nata nuk fle .....	30
Nuk është e vërtetë .....	31

Vogëlushes, që do të bëjë roje në varrezat e dëshmorëve	33
Nënë .....	35
Për një kryetar të këshillit popullor të fshatit .....	36
Burri me lavatriçe .....	37
Dy vjersha për Albanën .....	38
Duart e Albanës .....	39
Këshillë .....	40
Fjalët .....	41
Sa e madhe atë ditë .....	42
Kështu e qëndise atë qilim .....	43
Në zemrën e gjithë fëmijëve .....	44
C'madhësi parcelash .....	46
Po ngjitet në skenë .....	48
«Rënia e Varshavës» .....	49
Globi rrëth boshtit të shqetësimit .....	50
Bardhësi .....	52
Në serat e shpirtit tënd .....	54
Traktoristik .....	55
Goditje .....	56
Ne të dy .....	57
Cdo mëngjes .....	58
Sa mirë .....	59
Në pushime .....	60

Piktor Svetllana Strazimiri

Tirazhi 1.500 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike  
Shtypshkronja «8 NENTORI» — Tiranë, 1975